



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN E DISA ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË KZAZ-VE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 30, neni 31, neni 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Partia Socialiste e Shqipërisë, bazuar në nenin 32, pika 2, germa "d", të Kodit Zgjedhor, me shkresat nr. 12141, datë 22.06.2019 dhe nr.12149 prot., datë 24.06.2019, ka kërkuar:

- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 18, z. Asllan Daxha dhe emërim të z. Korab Kika;
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 62, zj. Leonora Bebi dhe emërim të zj. Zana Hyka;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 68, z. Vilson Braçe dhe emërim të zj. Rudina Bregu;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 70, z. Jonel Kambo dhe emërim të zj. Marjana Zyfil;
- lirim të anëtares së KZAZ nr. 42, zj. Dorina Uku dhe emërim të z. Andi Metolli;
- lirim të anëtarit të KZAZ nr. 27, z. Vangjel Kaziu dhe emërim të zj. Brunilda Balliu;

Me shkresën nr. 12190 prot., datë 24.06.2019, sekretarja e KZAZ nr. 26, zj. Elona Emini, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin nr. 141, datë 09.04.2019 për arsye objektive ka kërkuar dorëheqjen.

Në listën e shtetasve miratuar nga KQZ me vendimin nr. 140, datë 9.04.2019, pas plotësimit të vakancave të KZAZ me emërimet kryesisht nga KQZ, nuk rezultojnë shtetas të paemëruar me vendbanim në Bashkinë Vorë.

Nr. 863 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për lirim dhe emërimin e disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.



Në shqyrtim të kërkesave të shtetasve, në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, por që për shkak të paraqitjes në tejkalim të afatit, nuk janë bërë pjesë e lidhjes 1 të vendimit nr. 140, datë 09.04.2019, rezulton se shtetasi Donald Mezini, me vendbanim në Bashkinë Vorë, dhe arsim juridik, plotëson kushtet e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor për tu emëruar sekretar i KZAZ nr. 26.

Gjithashtu, për arsye objektive kanë paraqitur dorëheqje:

- zj.Jozefina Paloka anëtare e KZAZ nr.3, emëruar kryesisht me vendimin Nr. 829, datë 10.06.2019 të KQZ (shkresa nr.12003 prot., datë 21.06.2019);
- zj.Orjola Shahaj, anëtare e KZAZ nr.29, emëruar kryesisht me vendimin Nr. 141, datë 09.04.2019 të KQZ (shkresa nr.12147 prot., datë 24.06.2019);
- z. Adi Muja, sekretari i KZAZ nr. 36, emëruar kryesisht nga KQZ me vendimin nr.854, datë 22.06.2019 (shkresa nr. 12182 prot., datë 24.06.2019);

KQZ, në zbatim të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV" do të përzgjedhë përmes procedurës së shortit për plotësimin e vakancës së krijuar.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 30, nenin 31, nenin 32, pika 2 gërma "d", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 1.
2. Të emërojë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve sipas lidhjes 2.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

